



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (ZKM) – NR. 06/2023 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E
INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM¹**

¹ Rregullorja (ZKM) Nr. 06/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm është miratuar nga Kryeministri, me Vendimin Nr. 540/2023, të datës 03.07.2023.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 (3) dhe 28 (3) të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 12 (3) të Ligjit Nr. 08/L-067 për Inspektimet, nenit 19 (5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenit 9 (7) të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, nxjerr:

**RREGULLORE (ZKM) – NR. 06/2023 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE
SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË
PËRGJITHSHËM**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm.

**Neni 2
Përkufizimet**

Termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet në Ligjin përkatës për Inspektimet dhe Ligjin përkatës për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.

**Neni 3
Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm janë të përcaktuara me ligjin përkatës për inspektimet.

Neni 4

Misioni i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm

Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm ka për mision të drejtojë programin e reformës së inspektimit, të koordinojë dhe mbështesë aktivitetet e organeve inspektuese me objektivin përfundimtar uljen e barrës administrative mbi inspektimet, me qëllim mbrojtjen e interesit publik, përfshirë shëndetin publik, publikun, sigurinë dhe mjedisin në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 5

Struktura organizative e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm

1. Struktura organizative e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm është si në vijim:

1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2. Divizionet.

2. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm është dymbëdhjetë (12).

Neni 6

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:

1.1. Drejtori Ekzekutiv / Inspektori i Përgjithshëm;

1.2. Një (1) zyrtar i lartë ekzekutiv;

1.3. Një (1) zyrtar administrativ.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Përgjithshëm përcaktohen me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, dhe me ligjin përkatës të inspektimeve.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të lartë ekzekutiv dhe zyrtarit administrativ të Inspektorit të Përgjithshëm përcaktohen sipas legjislacionit përkatës për zyrtarë publikë.

4. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv është tre (3).

Neni 7

Divizionet e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm

1. Në kuadër të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm funksionojnë divizionet si në vijim:

1.1. Divizioni i Metodologjisë së Inspektiveve;

1.2. Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Koordinimit të Inspektiveve.

Neni 8

Divizioni i Metodologjisë së Inspektiveve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Metodologjisë së Inspektiveve janë:

1.1. Mbështet Inspektorin e Përgjithshëm dhe ministritë e linjës dhe njësitë e tyre në varësi, për avancimin e metodologjisë së inspektiveve për të arritur dhe vendosur standarde dhe parime të unifikuara për të gjitha inspektimet;

1.2. Harton udhëzimet e përgjithshme për treguesit e performancës për aktivitetet e inspektimit;

1.3. Mbështet inspektoratet qendrore dhe lokale lidhur me kryerjen e inspektiveve të përbashkëta, sipas programeve vjetore të tyre, bazuar në vlerësimin e rrezikut;

1.4. Ofron këshilla dhe konsultohet rregullisht me inspektoratet qendrore dhe komunale lidhur me hartimin dhe përmbajtjen e listave të kontrollit si dhe përfshirjen e tyre në platformën dixhitale e-inspektimi;

1.5. Konsultimi sipas paragrafi 1.4 të këtij neni është i detyrueshëm para miratimit të listave të kontrollit nga organi inspektues;

1.6. Harton udhëzuesit e hollësishëm për marrjen dhe trajtimin e mostrave, sipas llojit të inspektimit, si dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve;

- 1.7. Koordinon procesin trajnues dhe certifikues për inspektorët sipas ligjit;
 - 1.8. Koordinon procesin e hartimit të planeve vjetore të bazuara në rrezik;
 - 1.9. Promovon transparencën e sistemit të inspektimit dhe koordinon bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e inspektimeve;
 - 1.10. Koordinon publikimin e materialeve sipas ligjit nga organet inspektuese dhe promovon transparencën e inspektimeve, sipas ligjit;
 - 1.11. Mbështet Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm përmes kryerjes së detyrave tjera nga fusha e metodologjisë së inspektimeve, të specifikuar në ligjin për inspektimet.
2. Divizioni i Metodologjisë së Inspektimeve udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit, i cili i raporton Inspektorit të Përgjithshëm.
 3. Numri i të punësuarve në kuadër të këtij Divizioni është katër (4).

Neni 9

Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Koordinimit të Inspektimeve

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Mbikëqyrjes dhe Koordinimit të Inspektimeve janë:
 - 1.1. Ofron mendim këshillues për dokumentet standarde dhe procedurat e inspektimit për inspektoratet specifike me synim zbatimin adekuat të kërkesave ligjore për inspektimet;
 - 1.2. Mbështet procesin e hartimit të akteve nënligjore të parashikuara në ligjin për inspektimet dhe jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimeve, të ndërmarra nga qeveria në bazë të parimeve dhe rregullave të parashikuara në ligjin për inspektimet;
 - 1.3. Ofron këshilla dhe bashkëpunim për inspektoratet e nivelit qendror dhe komunal dhe siguron që parimet dhe procedurat e përcaktuara me ligjin përkatës për inspektimet, duke përfshirë procedurën e inspektimit, respektohen në mënyrë të saktë, si dhe koordinon veprimtarinë e tyre;
 - 1.4. Koordinon punët për zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e platformës elektronike të inspektimeve “e-Inspektimi”.
 - 1.5. Koordinon procesin e hartimit të raporteve vjetore të trupave inspektues, sipas ligjeve relevante dhe përgatit raportin e përgjithshëm vjetor mbi inspektimet;

- 1.6. Mbështet Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm përmes kryerjes së detyrave tjera nga fusha e mbikëqyrjes dhe koordinimit të inspektimeve, në pajtim me ligjin për inspektimet.
2. Divizioni i Mbikëqyrjes dhe Koordinimit të Inspektimeve udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit i cili i raporton Inspektorit të Përgjithshëm.
3. Numri i të punësuarve në kuadër të këtij Divizioni është pesë (5).

Neni 10

Shërbimet e përgjithshme dhe mbështetëse

Shërbimet e përgjithshme të menaxhimit duke përfshirë menaxhimin financiar, menaxhimin e burimeve njerëzore, auditimi i brendshëm, shërbimet e përbashkëta (logjistikë, transport, menaxhim i dokumenteve dhe shërbime tjera të ngjashme mbështetëse) ofrohen nga Zyra e Kryeministrit, për Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm.

Neni 11

Dispozitat Përfundimtare

1. Transferimi i stafit në përputhje me legjislacionin për zyrtarët publikë lejohet nëse konsiderohet e nevojshme për rrjedhën e punës.
2. Rritja ose zvogëlimi i numrit të personelit në përputhje me Ligjin për Buxhetin Vjetor nuk krijon nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur krijohen dhe/ose shfuqizohen strukturat organizative.
3. Në pajtim me paragrafin 2. të këtij neni, dispozitat e Ligjit për Buxhetin Vjetor janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Data: 03/07/2023

SHTOJCA I

Organogrami i Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm			
Pozicioni/struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri
- Inspektor i Përgjithshëm	Drejtues i Lartë 2		Totali 3: 1
- Zyrtar/e i/e Lartë Ekzekutiv/e;	Profesional 1	-Gr. 58	1
- Zyrtar/e Administrativ/e	Profesional 2	-Gr. 58	1

2.1. Divizioni i metodologjisë së inspektimeve			Totali 9:
- Udhëheqësi/e i/e Divizionit	Drejtues i Ulët		1
- Zyrtar/e i/e lartë për analizë dhe metodologji	Profesional 1	-Gr. 14	1
- Zyrtar/e i/e lartë për Ngritje të kapaciteteve	Profesional 1	-Gr. 5	1
- Zyrtar/e i/e lartë për Ngritje të kapaciteteve	Profesional 1	-Gr. 10	1
- Zyrtar/e i/e lartë për Komunikim dhe Informim			
2.2. Divizioni i mbikëqyrjes dhe koordinimit të inspektimeve			
-Udhëheqësi/e i/e Divizionit	Drejtues i Ulët		1
-Zyrtar/e i/e lartë për mbikëqyrje dhe koordinim të inspektorateve	Profesional 1	-Gr. 5	1
- Zyrtar/e i/e lartë për legjislacion dhe vlerësim të përshtatshmërisë ligjore të akteve ligjore	Profesional 1	-Gr. 1	1
- Zyrtar/e i/e lartë për menaxhimin e të dhënave dhe interoperabilitetin e platformës dixhitale (e-inspektimi)	Ekspert 6	-Gr. 51	1
-Zyrtar/e i/e lartë për menaxhimin me platformën e-inspektimi dhe Teknologji Informative	Ekspert 7	-Gr. 19	1